



01 Nr. 640/25 Dt. 09.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e realizimit të projektit: “Furnizim me ushqim dhe pije për fëmijë për çerdhen “Zambaku” në lagjen “11 Marsi”, për çerdhen “Dielli ynë” në lagjen “Bajram Curri” , dhe për çerdhen që pritet të hapet në lagjen “Ortakoll” për periudhë një (1) vjeçare, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës–pozicioni mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

